



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1280/1\_prot.

Tiranë, më 13.12.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 250 , Datë 13.12.2023**

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 244, datë 13.11.2023, e paraqitur nga Shoqata “Për drejtësi sociale”, përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës z. G.S, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të vendbanimit dhe çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, pala ankuese parashtron:

*“Organizata “Drejtësi Sociale”, e cila ka në fokus kryesor advokimin, mbrojtjen, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, veçanërisht grupet rome-egjiptiane, personat me aftësi të veçanta, studentët, të rinjtë, fëmijët, emigrantët, banorët/et e lokaliteteve periferike, etj, së fundmi ka vërejtur se është përdorur gjuhë urrejtje ndaj studentëve konviktore gjatë një eventit ku u njoftuan masat për nisjen e vitit të ri shkollor.*

*Në eventin publik të datës 8 shtator 2023, ku diskutohen masat për nisjen e vitit të ri shkollor , E. V, deklaroi si më poshtë:*

*“Nëse secili bën llogaritë e veta, nuk quhemi komunitet. Quhemi disa konviktore që secili ka adresën e vet. Qytetarët janë ndryshe. Ne nuk jemi në konvikt, ne jemi banorë dhe jemi qytetarë. Kjo do të thotë se arrijmë të arsyetojmë se kur do akomodojmë me prioritet fëmijët, kur do akomodojmë biznesin dhe kur do akomodojmë kantiere. Qyteti nuk është i pafundmë”<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> Linku i fjalimit: <https://lapsi.al/2023/09/08/xxxxxxx-fyen-serish-te-rinjte-qytetaret-jane-ndryshe-nuk-jane-si-konviktoret-video/>.

*Kjo nuk është hera e parë kur E.V përdor gjuhën anatemuose ndaj studentëve të ardhur me studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë (konviktorë), pasi këtë e ka bërë edhe më parë, në janar të vitit 2022, kur deklaronte se “Unë nuk luaj më vetë futboll, por kur shikoj padrejtësi reagoj. Ka kauza që nuk kanë pse të jenë të lidhura me interesin personal. Prandaj dallon konviktori nga qytetari. Nëse qyteti për ty është vendi ku fle, ha dhe kryen nevojat personale atëherë ti je një konviktor, ti je thjesht banor, por qytetar bëhesh kur reagon dhe bëhesh aktivist”*”

Pala ankuese pretendon se, shprehjet e përdorura më sipër nga kryebashkiaku i Tiranës, E.V, tregojnë gjuhë të theksuar diskriminuese ndaj studentëve të ardhur për studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë (konviktorë), duke nxitur paragjykimin dhe kuptimin pezhorativ të fjalës “konviktor” në shoqëri, si një person që thjesht “ha, fle dhe kryen nevojat personale”.

Pala ankuese pretendon se, në fjalimin e transkriptuar të z.V është përdorur gjuhë urrejtje dhe denigruese, e cila prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë studentët e ardhur për studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë (konviktorë)

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, pranimin, shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD përcaktohet se : *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Për drejtësi sociale” është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 6599, datë 14.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata “Për drejtësi sociale” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave që janë studentë të ardhur për studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë, të cilët janë konviktorë, nga shprehjet e përdorura nga z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë gjatë fjalimit të mbajtur nga ky i fundit në eventin publik të datës 08.09.2023.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, konstatohet se Shoqata “Për drejtësi sociale”, është një organizatë jofitimrurëse e krijuar, me qëllimin për të respektuar, promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore, në mënyrë që, pavarësisht dallimeve sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahinore identitetit gjinor, apo çdo aspekti tjetër, të mund të ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe të aksesojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike. Në mënyrë të veçantë objekti i veprimtarisë së kësaj organizate konsiston në advokimin, mbrojtjen në mënyrë proaktive dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, veçanërisht grupet si, romë-egjiptianë, persona me aftësi të veçanta, fëmijët, emigrantët, të burgosurit, punëmarrësit, besimtarët, banorët e lokaliteteve periferike, etj.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palës ankuese dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se pala ankuese legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Bazuar në nenin 3, pika 8, të LMD, gjuha e urrejtjes, parashikohet si një formë e veçantë diskriminimi me përkufizimin vijues: *“8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe*

*çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”*

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e pretendimit të palës ankuese lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë, nëpërmjet përdorimit të shprehjeve diskriminuese gjatë fjalimit të mbajtur në eventin publik të datës 08.09.2023, do t'i referohemi videos së publikuar *online* në portalin LAPSI, të vendosur në dispozicion nga pala ankuese nëpërmjet “*linkut*” të shënuar në ankesën e depozituar pranë Komisionerit.

Nga verifikimi i kryer nga ana e Komisionerit, rezulton se, fjalimi i plotë i mbajtur gjatë këtij eventit publik është publikuar edhe nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në profilin e tij zyrtar në rrjetin social “*Facebook*”<sup>2</sup>.

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, rezulton se, në datën 08.09.2023, në ambientet e Gjimnazit “Sami Frashëri”, në Tiranë është mbajtur një aktivitet publik, ku në fokus të të cilit kanë qenë masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024. Gjatë fjalimit të mbajtur në këtë aktivitet, referuar materialit video të administruar, rezulton se ndër të tjera z. EV, Kryetar i Bashkisë Tiranë, është shprehur: “*Nëse secili bën llogaritë e veta dhe ne kthehemi në një garë vetanake, ku secili sheh vetëm interesin e vet, nuk quhemi komunitet. Quhemi disa konviktorë që secili ka adresën e vet. Qytetarët janë ndryshe. Ne nuk jemi në konvikt, ne jemi banorë dhe jemi qytetarë. Kjo do të thotë që arrijmë të arsyetojmë se kur do akomodojmë me prioritet fëmijët, kur do akomodojmë biznesin dhe kur do akomodojmë kantiere. Qyteti nuk është i pafundmë. Rrugët tona janë të fundme. Do të thotë që brenda këtij qyteti ku vetëm shtohet popullsia, do të duhet që të paktën këto rrugë finite dhe këto hapësira publike të fundme, t'i shfrytëzojmë me radhë për të siguruar që secili mbaron punët e veta dhe sidomos fëmijët tanë shkëlqejnë.....”*

“*Gjuha e urrejtjes*”, si një formë diskriminimi, sipas LMD-së, nënkupton përdorimin e një ose më shumë *formave të shprehjes*, përkatësisht, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo shpifjes të një personi ose grupi personash, si dhe çdo shqetësim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes, që bazohet në një listë të hapur të shkaqeve të mbrojtura nga diskriminimi, të parashikuara në nenin 1, të LMD-së.

Sipas LMD-së, “*shprehja*” përfshin, fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video, por edhe sjellje të caktuara, siç janë gjestet për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.

---

<sup>2</sup> <https://www.facebook.com/xxxxxx/videos/266769122844597>

Pra, “Gjuha e urrejtjes”, lidhet me forma të ndryshme të shprehjes, që i drejtohen një personi apo grup personash, mbi bazën e statusit apo karakteristikave personale të personit apo grupit të personave dhe ekzistenca e kontekstit publik është kriter ligjor thelbësor. Shprehja konsiderohet e përdorur në publik kur ndodh në një vend/ambient fizik apo përmes mjeteve elektronike të komunikimit, në të cilat publiku i gjerë ka akses.

Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehja është realizuar nëpërmjet fjalëve, në mënyrë publike, pasi gjuha në shqyrtim e përdorur nga z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë është bërë në një ambient fizik publik dhe njëkohësisht është shpërndarë në platforma të tjera publike *online*.

Rekomandimi Nr.15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015<sup>3</sup>, e përkufizon “gjuhën e urrejtjes”: “*gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës" , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit”.*

Po sipas Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me gjuhë urrejtje ose jo, në mënyrë të veçantë duhet të mbahet parasysh: a) konteksti në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes); b) aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose komunitar); c) natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi); d) kontekstin e komenteve specifike (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati); e) mediumin (formatin) e përdorur (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt"); dhe f) natyrën e publikut (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi).

Në dy vendime, *Behar dhe Gutman kundër Bullgarisë* (nr. 29335/13, datë 16.02.2021) dhe *Budinova dhe Chaprazov kundër Bullgarisë* (nr. 12567/13, datë 16.02.2021), GJEDNJ, ka vendosur disa faktorë me rëndësi, (që nuk janë shterues) të cilët duhet të merren në konsideratë

<sup>3</sup> Në vijim referohet me akronimin Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t.

kur vlerësohet, nëse deklaratat publike negative në lidhje me një grup shoqëror ngrihen mbi “nivele të ashpërsisë” për t’u konsideruar diskriminuese. Faktorët me rëndësi, që sipas GJEDNJ duhet të merren në konsideratë janë:

1. Karakteristikat e grupit (për shembull madhësia e tij, shkalla e homogjenitetit, cenueshmëria e tij e veçantë ose historia e stigmatizimit dhe pozicioni i tij përballë shoqërisë në tërësi);
2. Përmbajtjen e saktë të deklaratave negative në lidhje me grupin (në veçanti, shkallën në të cilën ato mund të përcjellin një stereotip negativ për grupin në tërësi, dhe përmbajtjen specifike të atij stereotipi);
3. Formën dhe kontekstin në të cilin janë bërë deklaratat, shtrirjen e tyre (që mund të varet nga vendi dhe si janë bërë), pozicioni dhe statusi i autorit të tyre dhe shkalla në të cilën ato mund të konsiderohen se kanë ndikuar një aspekt thelbësor të identitetit dhe dinjitetit të grupit.

Sipas GJEDNJ-së, është ndërveprimi i të gjithë këtyre faktorëve që ka rëndësi. Pra, faktorët e sipërcituar duhen konsideruar në mënyrë kumulative që të mund të vlerësohet niveli i ashpërsisë.

Në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132), përcaktohet se: *“Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t’i atribuohet ndonjë shprehje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.”*

Pala ankuese, pretendon se, shprehjet e përdorura nga z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë gjatë aktivitetit publik të datës 08.09.2023, nxisin paragjykimin dhe kuptimin pezhorativ të fjalës “konviktor” në shoqëri, si një person që thjesht *“ha, fle dhe kryen nevojat personale”*. Pala ankuese pretendon se, gjuha e përdorur nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë është gjuhë denigruese dhe gjuhë urrejtje ndaj këtyre personave.

Duke ju referuar shprehjeve të përdorura nga z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë gjatë aktivitetit publik të datës 08.09.2023, gjatë të cilit pala ankuese pretendon se nga ky i fundit është përdorur gjuhë urrejtje, Komisioneri nuk konstaton që fjalimi i mbajtur nga z. V gjatë aktivitetit publik të datës 08.09.2023, përmban fjalë ose shprehje me natyrë të tillë që mund të konsiderohen si sulm i drejtpërdrejtë ose i nënkuptuar, ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të personave që janë studentë të ardhur për studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë, të cilët janë konviktorë. Në tërësinë e tij, fjalët dhe gjuha e përdorur gjatë fjalimit të mbajtur në aktivitetin publik të datës 08.09.2023 nga z. V, nuk sulmon, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të nënkuptuar



grupimin shoqëror të pretenduar nga pala ankuese. Është e dukshme që kuptimi i termave të cilat pretendohet se janë gjuhë urrejtje, i referohet përkohëshmërisë dhe cilësinë e të qenit të përkohshëm, të studentëve që vijnë në Tiranë nga qytete të tjera të Shqipërisë.

Komisioneri nuk konstaton, ndonjë sulm abuziv ndaj personave të pretenduar në fjalimin e datës 08.09.2023 nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë.

Në ankesën e depozituar pala ankuese pretendon se, z. E.V ka përdorur gjuhë urrejtje edhe në një rast tjetër, dhe konkretisht, në muajin janar të vitit 2022. Në lidhje me këtë pretendim, pala ankuese nuk ka vendosur në dispozicion të Komisionerit mënyrën se si mund të aksesohet dhe verifikohet pretendimi i palës ankuese, në lidhje me këtë rast.

Nga shqyrtimi i “*linkut*” të vendosur në dispozicion nga pala ankuese për gjuhën e përdorur gjatë aktivitetit të datës 08.09.2023, në shkrimin e publikuar *online* në Portalin LAPSI, konstatohet se, shkrimi të referon në një tjetër “link” të kësaj faqe *online*, ku pasqyrohet se z. E.V, ka deklaruar në muajin janar 2022 se,<sup>4</sup>: “..... Unë nuk luaj më vetë futboll, por kur shikoj padrejtësi reagoj. Ka kauza që nuk kanë pse të jenë të lidhura me interesin personal. Prandaj dallon konviktori nga qytetari. Nëse qyteti për ty është vendi ku fle, ha dhe kryen nevojat personale atëherë ti je një konviktor, ti je thjesht banor, por qytetar bëhesh kur reagon dhe bëhesh aktivist”. Përveç shkrimit të sipërcituar të publikuar *online* në Portalin LAPSI, pala ankuese nuk vendosi në dispozicion akte të tjera provuese.

Referuar parashtrimeve të bëra nga pala ankuese konstatohet se, janë pikërisht shprehjet e sipërcituara ato që përbëjnë edhe thelbin e ankesës, duke parashtruar se, z. E.V nëpërmjet shprehjeve të përdorura nxit paragjykimin dhe kuptimin pezhorativ të fjalës “konviktor” në shoqëri, si një person që thjesht “*ha, fle dhe kryen nevojat personale*”.

Komisioneri, thekson se, shprehje të ndryshme që mund të jenë fyese ose të karakterizuara nga paragjykimet dhe që mund të ngrejë shqetësime për mungesën e tolerancës, mund të mos përmbushin prapësinë e ashpërsisë për t’i përligjur ato si “*gjuhë urrejtje*” dhe rrjedhimisht si një formë diskriminimi sipas LMD.

Komisioneri thekson se, *gjuha e urrejtjes*”, konsiderohet e tillë, kur ajo përdoret që të nxisë apo krijoj pritshmërinë që të ketë efektin e nxitjes, drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shenjëstruar, që në rastin konkret pretendohet nga pala ankuese se janë studentë të ardhur për studime në Tiranë nga qytetet e tjera të Shqipërisë, të cilët janë konviktore.

---

<sup>4</sup> <https://lapsi.al/2022/01/24/xxxxxx-fyen-konviktoret-qytetar-nuk-te-ben-vendi-ku-ha-fle-dhe-kryen-nevojat-personale/>

Komisioneri, vlerëson se, edhe nëse marrim në konsideratë faktin se, fjalët dhe shprehjet e pretenduara nga pala ankuese janë përdorur nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashksië Tiranë, ato nuk nxisin apo krijojnë pritshmërinë që të kenë efektin e nxitjes, drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shenjëstruar, në mënyrë që të përmbushin pragun e ashpërsisë të kërkuar për t'u konsideruar "gjuhë urrejtje", sipas LMD. Dukshëm, shprehjet e përdorura nga ana e z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë nuk përlligjin kufizimin e lirisë së shprehjes.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa në tërësi konsiderohet e pabazuar dhe përfundimi i arritur nga pala ankuese se shprehjet e përdorura nga z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë nxisin urrejtjen, është i pabazuar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, i cili parashikon se: "*Ankesa nuk pranohet nëse: është haptazi e pabazuar.....* ", ankesa nr.244 datë 13.11.2023 e paraqitur nga Shoqata "*Për drejtësi sociale*" kundër z. E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 244, datë 13.11.2023, të paraqitur nga Shoqata "*Për drejtësi sociale*", pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Vendbanimi, çdo shkak tjetër  
Fusha: Gjuhë urrejtje  
Lloji i vendimit: Mospranim